



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1044/3 Prot.

Durrës, më 04.04.2025

VENDIM

Nr. 35, datë 04.04.2025

PËR

"NJË KORRIGJIM NË SHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE, NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR, TË FAKULTETIT TË STUDIMEVE PROFESIONALE, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës TË MIRATUARA ME VENDIMIN E SENATIT AKADEMIK NR. 9, DATË 10.02.2025"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 03.06.2020 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021-2022 e në vijim" i ndryshuar; në Statutin dhe Rregulloren e UAMD-së; në vendimin e Senatit Akademik Nr. 9, datë 10.02.2025; si dhe në shkresën e Drejtorisë së Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 201/3 prot., datë 02.04.2025 (bashkëlidhur), në mbledhjen e datës 04.04.2025 Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e një korrigjimi në shpërndarjen e kuotave të pranimin të studentëve, për vitin akademik 2025-2026, të miratuara me Vendimin e Senatit Akademik nr. 9, datë 10.02.2025, për programet e ciklit të parë të studimeve të Fakultetit të Studimeve Profesionale, përkatësisht:
 - Në programin Bachelor në "Menaxhim i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme", 1 (një) kuotë nga "persona me aftësi të kufizuara" kalon në kuota "të huaj";
 - Në programin Bachelor "Menaxhim Hoteleri Turizëm", 1 (një) kuotë nga "persona me aftësi të kufizuar" kalon në kuota "të huaj".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Administratori
 - Drejtuesi i Njësisë Kryesore të FSP
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

